



BASHKIA KORCE
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 23.04.2017]

Për: Bashkimin e Operatoreve Ekonomike “Almo Konstruksion” shpk (9.4%) & “Al Asphalt” shpk (53.4%) & “Eurondertimi 2000” shpk (37.2%), Perfaqesuar nga shoqeria “Almo Konstruksion” shpk.

Procedura e prokurimit: “Tender i Hapur” me objekt : "Sistemim asfaltim rruga Unaza Korce-Voskop-Polene-Korce”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Sistemim asfaltim rruga Unaza Korce- Voskop-Polene-Korce”.
Kohëzgjatja: brënda 15 muajsh nga data e fillimit të punimeve.

Fondi limit: 450.825.000 (katërqind e pesëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e pesë mijë) Lekë pa TVSH.

Fondi i akorduar për vitin 2017 është 125.000.000 (njëqind e njëzet e pesë milion) lekë pa tvsh. Pjesa e mbetur është parashikuar për vitin 2018.

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 09.03.2017.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

NR	SHOQERIA	OFERTA PA TVSH PARA KONTROLLIT ARITMETIK
1	BE - IS SH.P.K 56% 2T SHPK 44%	304,529,958
2	EUROTEOREMA PEQIN	315,000,000
3	CURRI 67.26% XHENGO 32.74%	343,078,417
4	G.P.G. COMPANY	345,366,825
5	DELIA GROUP MANE TCI	353,088,152
6	N.T.P. Eurokos-Dega ne Shqiperi DENIS 05	354,712,109
7	ALMO KONSTRUKSION AL ASFALT EURONDERTIM 2000	358,790,788
8	ALKO-IMPEX General Construcion	374,996,886
9	Victoria Invest International VICTORIA INVEST	378,936,090
10	Delta Lavori 76.4% ERNIKU 18.6% KOLA INVEST 5%	404,350,462
11	ULEZA NDERTIMI AGBES KONSTRUKSION	411,530,327
12	ALBA KONSTRUKSION	419,206,651
13	GENER 2	419,274,562
14	Ali Hyko	NUK KA OFERTE
15	VARAKU E	NUK KA OFERTE

Pas vleresimit të dokumentacionit të paraqitur komisioni me unanimitet vendosi:

Te skualifikojë bashkimin e perkohshëm të shoqerive “Be - Is” shpk (56%), dhe “2T” shpk (44%) për arsye se:

Shoqeria “Be-Is” shpk nuk plotëson piken 2.2.4 të Kërkesave të Vecanta për Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar punëve në proces të deklaruara, kryen aktivitet në Durrës, Librazhd

dhe Vlore nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

Shoqeria "2T" shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne ne Qukes ku qysh prej 07.03.2016 po punon ne objektin "Ndertimi i rruges Qukes Qafe Plloce" Per rrjedhoje edhe deklarata e paraqitur ne perputhje me kriterin 2.2.5 per kualifikim rezulton te jete e rreme.

Shoqeria "2T" shpk nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve: "Rruga Farke – Rruga E Elbasanit" me vlere 95.937.136 leke pa tvsh. Kjo pune nuk eshte e mjaftueshme per plotesimin e kriterit per kualifikim pasi bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper, vlere per nje objekt te vetem duhet te ishte 99.181.500 leke pa tvsh.

"Rruga Grabom - Kufiri me Malin e Zi". Per kete pune mungon formulari i vleresimit. Puna eshte realizuar si joint venture, por mungojne te dhenat per perqindjen e realizuar nga secila kompani.

"Punime per ndertimin e by passit te Rrogozhines". Per kete pune mungon formulari i vleresimit.

Shoqeria "2T" shpk nuk ploteson piken 2.3.5 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punesimin e mjekut, pasi kontrata me mjekun eshte lidhur ne daten 05.01.2017 dhe jo nga Nentori 2016 e ne vazhdim sic kerkohet ne kerkesen per kualifikim.

Te skualifikoje shoqerine "Euroteorema Peqin" shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Milot – Lezhe - Rreshen nga viti 2011 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier ndertimi me profilin transport, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive "Curri" shpk (62.26%%), dhe "Xhengo" shpk (32.74%) per arsye se:

Shoqeria "Xhengo" shpk nuk ploteson kerkesen lidhur me shlyerjen e detyrimeve per energjiine elektrike per muajin janar 2017, detyrim ky i maturuar ne daten e tenderit. Ofertat jane hapur ne daten 9 mars 2017 dhe ne kete date ka qene maturuar afati i pageses per muajin janar 2017. Vertetimi i paraqitur shprehet vetem per pagesen e muajit dhjetor, pa perfshire faturen e muajit janar.

Shoqeria "Xhengo" shpk nuk ploteson kerkesen lidhur me stafin pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier ndertimi me profil transporti dhe nje inxhinier gjeodet, nderkohe qe, regeruar marreveshjes se bashkepunimit , ka marre persiper te kryeje punime shtresash rrugore ne te cilat keta specialiste jane te domosdoshem.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

Te skualifikoje shoqerine "GPG" shpk per arsye se:

Nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve:

“Rikonstrukcion i rruges Lushnje Hysgjokaj”, realizuar ne vitet 2013 – 2014. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne 3 vitet e fundit per kete objekt eshte 167.339.118 leke.

“Ndertim rruga Lushnje Berat loti 1”, realizuar ne vitet 2011 – 2014. Vlera e punimeve pa tvsh te kryera ne tre vitet e fundit ne kete objekt eshte 66.067.147 leke pa tvsh.

Kjo shoqeri per te provuar plotesimin e kriterit per kualifikim duhet te kishte paraqitur dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 225.412.500 leke pa tvsh ose te disa puneve te realizuara ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 901.650.000 leke pa tvsh.

Ky operator ekonomik, me dokumentacionin e paraqitur, nuk ploteson asnjeren prej kushteve.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Delia Group” shpk (38%) dhe “Mane TCI” shpk (62%) per arsye se:

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson kerkesen per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve pasi ka paraqitur dokumentacion vetem per nje kamioncine.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ka paraqitur formularin e deklarimit te mjeteve.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson piken 2.3.1 per kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objektit “Infrastruktura rrugore dhe rrjeti i jashtem inxhinierik ne kompleksin Rolling Hills”. Punimet kane filluar ne vitin 2009. Per kete objekt mungon formualri i vleresimit i percaktuar ne kerkesat per kualifikim. Vlera totale e objektit (referuar aktit te kolaudimit) eshte 1.284.225.319 leke me tvsh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur komisioni verejti se punimet e kryera jane kryesisht punime ndertimore (punime betoni etj) dhe nuk kane ngjashmeri me punimet rrugore qe prokurohen me proceduren aktuale.

Shoqeria “Mane TCI” nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi ka paraqitur dokumentacion vetem per nje inxhinier ndertimi dhe nje inxhinier ndertimi i profilit transport.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “NTP Eurokos” shpk (91%) dhe “Denisi 05” shpk (9%) per arsye se:

Shoqeria “NTP Eurokos” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Vlore dhe Elbasan - Librazhd nga viti 2016 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “NTP Eurokos” shpk nuk ploteson piken 2.3.2 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me numrin e punonjesve pasi ka mesatarisht 76 punonjes ne Kosove dhe 46 punonjes ne Shqiperi, ne total 122 punonjes, nga 127 qe duhet te kishte sipas perqindjes se puneve qe ka marre persiper (91%).

Shoqeria “NTP Eurokos” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier ndertimi me profil transport, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit, nderkohe qe ka marre persiper te kryeje punime rrugore ne te cilat ky specialitet e shte i domosdoshem.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete bashkim shoqerish.

Te skualifikoje shoqerine “Alko Impex General Construcion” shpk per arsye se:

Shoqeria “Alko Impex” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Librazhd, Devoll, Koplik dhe Kavaje nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “Alko Impex” shpk nuk ploteson piken 2.3.3 per kualifikim lidhur me stafin e nevojshem pasi nuk ka paraqitur dokumentacion per nje inxhinier mjedisi, sic kerkohet ne dokumentet e tenderit.

Duke qene se keto te meta jane thelbesore, komisioni vendosi te mos vazhdoje me me shqyrtimin e dokumentacionit te mbetur per kete shoqeri.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Viktoria Invest International” shpk (54%) dhe “Victoria Invest” shpk (46%) per arsye se:

Shoqeria “Viktoria Invest International” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Tirane nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore.

Shoqeria “Viktoria Invest International” shpk nuk ploteson piken 2.3.1 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me punet e ngjashme, pasi per te provuar realizimin e puneve te ngjashme ka paraqitur dokumentacion per realizimin e objekteve:

“Sistemim asfaltim rruga Librazhd - Qafe Stude loti 3”. Per kete pune kontrata eshte lidhur ne daten 06.05.2011 dhe puna eshte perfunduar ne daten 30.09.2015. Vlera e plote me tvsh e kesaj pune eshte 2.270.873.995 leke. Vlera e plote pa tvsh e puneve te realizuara ne tre vitet e fundit eshte 139.915.701 leke

“Rikonstruksion i rruges Grekan – Dëshiran – Vlashuk (Kozare)”. Per kete pune kontrata eshte lidhur ne daten 27.12.2012 dhe puna eshte perfunduar ne daten 20.11.2014. Vlera e plote me tvsh e kesaj pune eshte 454.641.388 leke. Vlera e plote pa tvsh e puneve te realizuara ne tre vitet e fundit eshte 160.818.672 leke.

Bazuar ne perqindjen e puneve qe ka marre persiper (54%), kjo shoqeri per te provuar plotesimin e kriterit per kualifikim duhet te kishte paraqitur dokumentacion per realizimin e nje pune te vetme ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 225.412.500 leke pa tvsh ose te disa puneve te realizuara ne tre vitet e fundit me vlere jo me pak se 486.891.000 leke pa tvsh.

Ky operator ekonomik, me dokumentacionin e paraqitur, nuk ploteson asnjeren prej kushteve.

Shoqeria “Viktoria Invest” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, nga viti 2016 ushtron aktivitet ne Librazhd (ne objektin “Rikualifikim urban, zona ne hyrjen perendimore te qytetit Librazhd dhe mbrojtje lumore”, me vlere 82.200.510 leke) dhe ne Bilisht (ne objektin “Rikualifikim urban i qendres se qytetit Bilisht, loti i”, me vlere 102.536.108 leke. Per keto dy objekte nuk ka paguar detyrimet vendore dhe nuk i ka regjistruar ne QKB.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Delta Lavori” shpk (76.4%), “Erniku” shpk (18.6%) dhe “Kola Invest” shpk (5%) per arsye se:

Ne marreveshjen e bashkepunimit ndermjet dy shoqerive nuk jane percaktuar punet konkrete qe do te kryeje secila shoqeri, ne perputhje me VKM.

Te skualifikoje bashkimin e perkohshem te shoqerive “Uleza Ndertim” shpk (55.927%) dhe “Agbes Konstruksion” shpk (44.073%) per arsye se:

Shoqeria “Uleza Ndertim” nuk ka te punesuar nje inxhinier ndertimi me profilin transport, sic eshte kerkuar ne dokumentet e tenderit, ndonese ka marre persiper te kryeje punime rrugore. Kjo shoqeri ka paraqitur dokumentet e ing Luan R. i cili eshte diplomuar ne vitin 1974 si inxhinier ndertimi. Shoqeria “Uleza Ndertim” shpk, me nje deklarate te ngarkuar ne sistem, pretendon se ing Luan R. eshte njekohesisht edhe inxhinier ndertimi me profil transport, pasi ne kohen qe ai ka mbaruar studimet profili transport ishte i perfshire. Kjo deklarate eshte e pa mbeshtetur ne ligj dhe shoqeria duhet te kishite punesuar per kete qellim nje inxhinier ndertimi me profilin transport, si shume shoqeri te tjera ofertuese. Ne perfundim, ndonese shoqeria “Uleza Ndertim” shpk ka marre persiper te kryeje punime rrugore nuk ka te punesuar inxhnier ndertimi me profil transport; per kryerjen e ketyre punimeve ky specialitet eshte i domosdoshem.

Shoqeria “Uleza Ndertim” shpk nuk ploteson piken 2.2.4 te Kerkesave te Vecanta per Kualifikim lidhur me taksat vendore pasi, referuar puneve ne proces te deklaruar, kryen aktivitet ne Puke, Mirdite dhe Kurbin nga viti 2015 e ne vazhdim dhe nuk ka paraqitur dokumentacion per shlyerjen e detyrimeve vendore. Ne kete menyre edhe deklarimi per shlyerjen e te gjitha detyrimeve te taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitet 2014 – 2015 dhe 2016 rezulton i rreme.

Shoqeria “Uleza Ndertim” shpk nuk ploteson piken 2.3.7 per kualifikim lidhur me disponimin e mjeteve, pasi referuar marreveshjes se bashkepunimit ka marre persiper punime per shtresat rrugore dhe nuk ka paraqitur asnje dokumentacion per disponimin e:

Gurëthyes, frontoje – 1 copë

Fabrikë asfalti – 1 copë

Implant automatik betoni – 1 copë

Furçe mekanike për pastrim(fshese) – 1 copë

Freze asfalti – 1 copë

Keto mjete jane te domosdoshem per realizimin e punimeve qe kjo shoqeri ka marre persiper. Vihet re se ne kontraten e bashkepunimit nuk cilesohet se mjetet qe disponon shoqeria “Agbes Konstruksion” shpk do te mund te perdoren edhe nga shoqeria “Uleza Ndertim” shpk.

Te skualifikoje shoqerine “Ali Hyko” shpk e cila nuk ka paraqitur oferte.

Te skualifikoje shoqerine “Varaku E” shpk e cila nuk ka paraqitur oferte.

Te konsideroj te kualifikuara shoqerite e meposhtme te cilat plotesojne kerkesat per kualifikim.

“Almo Konstruksion” shpk

“Alba Konstruksion” shpk

“Gener 2” shpk

Komisioni beri kontrollin e veprimeve aritmetike te preventivave te shoqerive te kualifikuara dhe konstatoi se nuk ka ka gabime aritmetike.

Komisioni kontrolloi per oferta anomalisht te uleta dhe konstatoi se ofertat nuk jane anomalisht te uleta.

NR	OPERATORI EKONOMIK	OFERTA PA TVSH	RENDITJA
1	ALMO KONSTRUKSION AL ASFALT EURONDERTIM 2000	358,790,788	RENDITET NE VEND TE PARE
2	ALBA KONSTRUKSION	419,206,651	RENDITET NE VEND TE DYTE
3	GENER 2	419,274,562	RENDITET NE VEND TE TRETE

Secili prej anetareve te Komisionit te Vleresimit te Ofertave do te beje mbylljen ne sistem ne menyre individuale.

Ne daten 11.04.2017 paraqiti ankese per vleresimin shoqeria "Victoria Invest International" shpk. Ankeses ju kthye pergjigje ne daten 12.04.2017. Ankesa te tjera nuk ka patur.

